



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 103, Datë 20.03.2023

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË “SEKA HYDROPOWER” SH.P.K., PËR RISHIKIMIN DHE PEZULLIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 17, DATË 06.02.2023 “MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 146, DATË 10.09.2020, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SEKA HYDROPOWER” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “SEKË” ME KAPACITET TË INSTALUAR 12667 KW DHE “ZAIS”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2295 KW, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 14962 KW”

Në mbështetje të neneve 1, 16, pika 5, 83, 85 dhe 90 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 33, pika 2 dhe 180, pika 1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neneve 5, pika 23, 15 dhe 16 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 03.09.2016; Vendimin nr. 559 (86-2021-671), datë 10.11.2021 të Gjykatës së Lartë, “Lënien në fuqi të vendimit nr. 49, datë 18.01.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë., datë 10.11.2021”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.03.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1011/2 prot., datë 17.03.2023, të Drejtorive Teknike “Mbi kërkesën e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., për rishikimin dhe pezullimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 17, datë 06.02.2023 “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.09.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Sekë” me kapacitet të instaluar 12667 kW dhe “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kW, me kapacitet total të instaluar 14962 kW”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 17, datë 06.02.2023 “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.09.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Sekë” me kapacitet të instaluar 12667 kW dhe “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kW, me kapacitet total të instaluar 14962 kW”, ku ndër të tjera, vendosi ndryshimin: Në pikën 1, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.09.2020, hiqen fjalët: 1. ...dhe “Zais” me kapacitet të instaluar 2295 kW, me kapacitet total 14962 kW”.

- Shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k., përmes shkresës protokolluar në ERE me nr. 369/3 prot., datë 24.02.2023 dhe e-mailit të datës 23.02.2023 ka paraqitur në ERE argumentet dhe provat e saj për rishikimin dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimmarrjes së sipërcituar, deri në shqyrtimin e kërkesës për rishikim, brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 5 të ligjit nr. 43/2015. Po ashtu, përmes shkresës së datës 21.02.2023, ka risjellë në mbështetje të argumenteve të saj, Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 59, datë 26.01.2022, “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (Kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore”, e cila është trajtuar dhe në vendimmarrjet e mëhershme të bordit të ERE.
- Rregullorja për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016 ka të parashikuar në nenin 16 (Ridëgjimi dhe Ankimi kundër vendimit të Bordit), pika 2 të saj, përveç sa cituar në nenin 16, pika 5 të ligjit nr. 43/2015, i ndryshuar, edhe se bordi do të shqyrtojë provën e re dhe do të nxjerrë vendimin e tij brenda 30 ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës për rishikim.
- Kusht thelbësor për rishikimin e një vendimi të ERE-s është paraqitja e provave të reja nga palët e përfshira në proces. Shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k., në shkresën e datës 21.02.2023, ka depozituar në mbështetje të argumenteve të saj VKM-në nr. 59, datë 26.01.2022, “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (Kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore”, e cila është trajtuar dhe në vendimmarrjet e mëhershme të bordit të ERE.
- Lidhur me kërkesën për pezullim të shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., sqarojmë se: pikat 3 dhe 4, të nenit 16 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, njohin të drejtën e bordit të ERE për të **pezulluar** aktin e miratuar nga vetë ai, sipas një kërkesë të paraqitur nga një subjekt i interesuar, në përputhje me rrethanat specifike.
- Kodi i Procedurave Administrative, nga ana tjetër, në nenin 180 (Pezullimi i ekzekutimit) ka përcaktuar se ekzekutimi i detyrueshëm pezullohet kryesisht ose me kërkesë të subjektit të ekzekutimit në rastet kur: *vërtetohet se ekziston rreziku i shkaktimit të një dëmi të rëndë dhe të pazëvendësueshëm për subjektin e ekzekutimit dhe pezullimi në këtë rast nuk e cenon interesin publik; vlerësohet se pretendimet e ngritura nga ana e shoqërisë lidhur me sa parashikuar në nenin 180, gërma “a”, nuk arrin të provojnë përmbushen në mënyrë kumulative të kushteve të sipërcituara.*
- Sa më sipër, vlerësohet se argumentimi i palës kërkuese nuk ka përmbushur kushtin për sa i përket sigurimit të një prove të re dhe as kushtin e ekzistencës së rrezikut të shkaktimit të dëmit të rëndë dhe të pazëvendësueshëm, pasi *Vendimi i ERE-s nr.146, datë 10.09.2020* që u shfuqizua pjesërisht nga vendimi i Gjykatës së Apelit (sipërcituar) nuk ishte objekt i shqyrtimit apo pjesë integrale vendimin e këshillit të ministrave - *VKM nr. 59 datë 26.01.2022 (ku është është përcaktuar kufiri i zonës së mbrojtur Lurë-Mali i Dejës Park Kombëtar)*, ndërkohë që

Vendimi i shfuqizimit i përket përkatësisht vitit 2020 (sa cituar më sipër), cila mund të çonte bordin në një vendimmarrje ndryshe e parashikuar në nenin 16, pika 1 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 03.09.2016.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Mospranimin e kërkesës se shoqërisë “Seka hydropower” sh.p.k., për rishikimin (shfuqizimin) dhe pezullimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 17, datë 06.02.2023 *“Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.09.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “Seka hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Sekë” me kapacitet të instaluar 12667 kw dhe “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw”.*
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI